

**Nr. 2411/20 K (e-k) Prot.**  
**Tiranë, më datë 07/11/2024**

**Drejtuar:** Komisionit Qendror të Zgjedhjeve  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Komisionit Rregullator

**Lënda:** REKOMANDIME – *Lidhur me Projektvendimin “Për miratimin e rregullave për procedurat e votimit nga jashtë vendit.”*

**I nderuar z. Komisioner!**  
**Të nderuar Anëtarë të Komisionit Rregullator!**  
**Të nderuar Drejtues të Administratës së KQZ-së!**

Në kuadër të bashkëpunimit me ju lidhur me konsultimin paraprak të projekt-akteve, për të cilin gjejmë rastin **t’ju falënderojmë sërish**, lidhur me *projektvendimin “Për miratimin e rregullave për procedurat e votimit nga jashtë vendit”*,

**KRIIK ju paraqet më poshtë qëndrimin e vet lidhur me këtë Projektvendim.**

Në parantezë, KRIIK ju ri-sjell në vëmendje **çështjen e vlefshmërisë ose jo të dokumentit të identifikimit** të shtetasve që jetojnë jashtë dhe kufizimin e mundshëm të shprehjes së të drejtës së tyre të votës, lidhur me këtë element formal.

Nisur nga praktika e ndjekur në zgjedhjet e mëparshme dhe diskutimet e shumta mbi vlefshmërinë e dokumentit të zgjedhësit, KRIIK gjykon dhe nxit **KQZ-në që, në respekt dhe zbatim të përcaktimeve të bëra në Kodin Zgjedhor, të bëjë përpjekjet e duhura**, në bashkëpunim edhe me partitë politike parlamentare si dhe Ministrinë e Brendshme e atë të Jashtme, **për të udhëzuar përsheptimin e procedurave të pajisjes me dokumente identifikimi të shtetasve që jetojnë jashtë**, për efekt të pjesëmarrjes së tyre në zgjedhje.

Po ashtu, nxitet **KQZ-ja që të ndërveprojë me Ministrinë e Brendshme dhe me Këshillin e Ministrave** lidhur me faktin se, nëse do të gjykohet që të shtyhet afati i vlefshmërisë së dokumenteve të identifikimit, akti ligjor përkatës të miratohet së paku 3 muaj përpara datës së zgjedhjeve. **Kjo do të siguronte zbatimin e parimit të barazisë**, pra të kushteve të barabarta në këtë aspekt, për të gjithë shtetasit me dokumente identifikimi jo të vlefshme ditën e zgjedhjeve, pavarësisht nëse ata do të votojnë brenda apo me postë nga jashtë vendit.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",  
Nd.4, H.2, Ap.3,  
Nj.Adm.5,  
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396  
Tirana, 1001,  
Albania

## Lidhur me përmbajtjen e projekt-vendimit, rekomandohet si më poshtë vijon:

**I.** Në Kreun II, Pika 1 e projekt-vendimit parashikohet se: *“Të drejtën e votës nga jashtë vendit e ka çdo shtetas shqiptar me të drejtë vote, emri i të cilit gjendet në listën përfundimtare të zgjedhësve nga jashtë dhe që në PER ka ngarkuar një dokument identifikimi të vlefshëm përpara miratimit të kësaj liste.”*

KRIIK rekomandon se nevojitet të qartësohet e shkruhet eksplicisht që në PER duhet të ngarkohet një **dokument i vlefshëm identifikimi në ditën e zgjedhjeve**, sikurse Kodi Zgjedhor përcakton për këdo zgjedhës që voton.

**II.** Në Kreun II, Pika 2 e projekt-vendimit parashikohet se: *“Fleta e votimit nga jashtë vendit është për çdo zonë zgjedhore, e njëjtë me fletën e votimit që përdoret brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, por me një element të veçantë dallues”*

KRIIK rekomandon se nevojitet të shtohet edhe përcaktimi se **fleta e votimit duhet të mos përmbajë asnjë kod elektronik të lexueshëm**, pra as “barkod” dhe as “qrkod”.

Kjo në funksion të sigurisë për mos-identifikimin në asnjë rast të votës, gjë e cila mund të ndodhë nëse lidhet barkodi i fletës së votimit me emrin e zgjedhësit të cilit i dërgohet fleta dhe me administrimin e numërimit të saj më pas, proces ky i monitoruar e regjistruar me kamera me rezolucion të lartë.

**KQZ-ja duhet të japë garanci të plotë dhe mbajë barrën e provës që procesi i fshehtësisë së votës nuk mund të çenohet në asnjë rrethanë**, pavarësisht administrimit të tërë procesit nga administrata e KQZ-së dhe garancive deklarative apo etike që mund të jepen në këtë drejtim.

Nëse për efekt të prodhimit të fletëve e numërimit të tyre paraqitet e nevojshme të vendoset një kod numërtues, çdo kod elektronik apo numërimi të vendoset në kundrafletën e fletës apo bllokut të fletëve të votimit, por në asnjë rast të mos ekzistojë mundësia e lidhjes, direkt apo indirekt, e çfarëdo kodi apo numërimi të përdorur me fletën e votimit.

**III.** Në Kreun III.2, pika 3 e projekt-vendimit parashikohet se: *“Dërgimi i dokumentacionit zgjedhor bëhet nëpërmjet një shërbimi postar që mundëson gjurmimin e dërgesës.”*

KRIIK rekomandon se nevojitet të përcaktohet eksplicisht se dërgimi i dokumentacionit zgjedhor të bëhet **detyrimisht** nëpërmjet një shërbimi **të shpejtë** postar që mundëson gjurmimin e dërgesës.

KRIIK gjykon se në kushtet e kohës së konsiderueshme që kërkon dërgesa me postë, shqetësim ky i ngritur edhe nga vetë KQZ-ja, kjo e fundit **duhet të mos harxhojë më shumë se 2-3 ditë për të dërguar** dokumentacionin zgjedhor tek zgjedhësit jashtë vendit, duke i lënë sa më shumë kohë në dispozicion atyre për dërgimin me postë të votës së tyre. Duke qenë se kosto financiare e dërgimit të votës në KQZ do të mbulohet nga vetë zgjedhësit, është e natyrshme që ata të zgjedhin kompani postare të ndryshme, të shpejta ose jo. Në rastin e dytë paraqitet detyrimisht nevoja që zgjedhësve tu lihet sa më shumë kohë në dispozicion në mënyrë që ata të mund ta dërgojnë votën e tyre në KQZ edhe me postë të thjeshtë.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",  
Nd.4, H.2, Ap.3,  
Nj.Adm.5,  
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396  
Tirana, 1001,  
Albania

KRIIK gjykon se vendimi i ligjvënësit për t'i mbuluar shteti kostot e dërgimit të dokumentacionit zgjedhor dhe diskrecioni që KQZ-ja i ka dhënë vetes për suksesin e këtij procesi madhor, duhet ta nxisë atë për të kërkuar fondin e nevojshëm financiar për të përbulluar shërbimin e shpejtë postar.

**IV.** Lidhur me pikën 4 të Kreut III.2 (“Komisioni Qendror i Zgjedhjeve fillimisht bën përpjekje të përzgjedhë ofrues ndërkombëtarë të shërbimit postar me jashtë vendit, të cilët kanë eksperiencë dhe reputacion të mirë në shërbimin e postës së shpejtë. Zgjedhja e këtij operatori realizohet nëpërmjet procedurave më afatshkurtra që mundëson legjislacioni për prokurimin publik”), gjykohet se duhet të shtohet në vijim apo në një pikë të veçantë se **KQZ-ja shpall thirrjen dhe kontakton paraprakisht me operatorët e postës së shpejtë**, të cilët ftohen të shprehin interesin paraprakisht dhe ofertën financiare me fasha të numrit të dërgesave dhe sipas vendeve të ndryshme.

Gjithashtu këto kompani deklarojnë paraprakisht përmbushjen e çdo parametri tjetër të kërkuar prej KQZ-së lidhur me zbatimin e këtij procesi, së bashku me garancitë përkatëse që ato ofrojnë.

Ky përcaktim shtesë do të mund t'i japë mundësi KQZ-së të njohë paraprakisht terrenin dhe ofertat e kompanive në treg, përfshirë përmbushjen e tërë parametrave të tjerë të kërkuara, duke fituar kohë e thjeshtuar më pas edhe procesin e vendimmarrjes në përzgjedhjen e kompanisë me të cilët do të lidhë kontratë.

Gjithashtu, gjykohet se është e nevojshme që të përcaktohet në këtë akt, në këtë kre apo në një tjetër, **se aktmarrëveshjet apo kontratat e lidhura midis KQZ-së dhe kompanisë/ve përkatëse duhet të përmbajnë të detajuara edhe përgjegjësitë e nevojshme administrative e ato penale** në rast të cënimit të garancive dhe shkeljes së akteve rregullatore të miratuara nga KQZ-ja.

**V.** Në Kreun III.3, pika 2 e projekt-vendimit parashikohet se: “Pasi plotëson fletën e votimit, zgjedhësi e vendos atë në zarfin e fletës së votimit të dërguar nga KQZ. Në zarfin e fletës së votimit vendoset/futet vetëm fleta e votimit dhe asnjë dokument tjetër.”

KRIIK rekomandon se në këtë pikë nevojitet të shtohet **një fjali lidhur me karakteristikat e zarfit ku do të vendoset fleta e votimit.**

Sugjerohet që të përcaktohet se **zarfi duhet të jetë i përbërë nga një letër e trashë, me ngjyrë të veçantë dhe i pa tejdukshëm**, duke siguruar në mënyrë të plotë mosleximin me asnjë lloj forme apo mjeti të përdorur të fletës të votimit që do të përmbajë në brendësi.

**VI.** Në Kreun III.3, pika 4 e projekt-vendimit parashikohet se: “Zarfi i fletës së votimit, i cili përmban vetëm fletën e votimit, vendoset në një zarf tjetër të siguruar nga vetë zgjedhësi, i cili ka dimensione të rekomanduara nga KQZ. Mbi këtë zarf zgjedhësi duhet të vendosë/ngjisë Kodin Unik të regjistrimit të tij në PER, të cilin ai e printon nga kjo platformë. Kodi Unik i zgjedhësit gjenerohet automatikisht nga PER dhe përmban emër, mbiemër të zgjedhësit, shtetin ku ka kërkuar t'i dërgohet fleta e votimit, si dhe qarkun ku ka regjistruar e gjendjes civile në Republikën e Shqipërisë. Kodi Unik i zgjedhësit është gjithashtu i pasqyruar në formën e një Barcode, ose QR Code.”

**Address:**

Rr. "Ymer Kurti",  
Nd.4, H.2, Ap.3,  
Nj.Adm.5,  
Tirana

**Mailingaddress:**

P.O.Box. 2396  
Tirana, 1001,  
Albania

Pra thuhet se zarfi i fletës së votimit, i cili përmban vetëm fletën e votimit, vendoset në një zarf tjetër të siguruar nga vetë zgjedhësi, i cili ka dimensione të rekomanduara nga KQZ.

KRIIK rekomandon që, për të lehtësuar procesin, ngarkesën e shtetasit, por edhe shmangien e keqkuptimeve të mundshme, **zarfi i dytë**, në të cilin futet zarfi i parë që përmban fletën e votimit, duhet të **merret përsipër e të dërgohet nga KQZ-ja së bashku me dokumentacionin zgjedhor**.

Sugjerohet gjithashtu që ky **zarf i dytë të jetë dukshëm më i madh se zarfi i parë ku futet fleta e votimit, si dhe të ketë një ngjyrë të ndryshme nga ai**.

Më pas të mund të udhëzohet zgjedhësi për procedurat në vijim nëpërmjet referimit të ngjyrës dhe madhësisë së zarfit.

**VII.** Në Kreun III.3, pas pikës 6 (“*Dërgimi i dokumentacionit zgjedhor nga zgjedhësi për në KQZ, rekomandohet të bëhet nëpërmjet një shërbimi postar i cili mundëson gjurmimin e dërgesës. Zgjedhësi duhet të kujdeset që dërgimi i dokumentacionit zgjedhor për në KQZ të bëhet brenda një afati i cili mundëson mbërritjen e tij në Republikën e Shqipërisë brenda orës 19:00 të ditës së zgjedhjeve.*”), **rekomandohet** të shtohet një pikë ku të përcaktohet se **zgjedhësi njofton nëpërmjet PER, ditën, datën, orën dhe emrin e kompanisë** prej nga ka nisur zarfin.

Gjithashtu sugjerohet të ofrohet nëpërmjet PER mundësia që **të tregohet nga zgjedhësi koha e përafërt (në ditë ose datë) se kur pritet që zarfi i nisur të mbërrijë** në Shqipëri, pasi zgjedhësi ta ketë marrë këtë informacion nga kompania ku ai ka nisur zarfin.

Ky informacion do do të ndihmojë KQZ-në dhe tërë aktorët e interesuar të kenë një panoramë më të plotë dhe dijëni paraprake mbi numrin e përfaërt të zarfave të votimit që mund të vijnë deri në afatin e caktuar nga Kodi Zgjedhor, e sa pas tij.

Po ashtu, PER sugjerohet që të ofrojë gjithashtu edhe mundësinë që **zgjedhësi të tregojë nëse kompania ku ka nisur zarfin ofron ose jo gjurmim të dërgesës**, si dhe mënyrën apo adresën se si mund të gjurmohet ajo.

**VIII.** Në Kreun III.4, pika 2 e projekt-vendimit parashikohet se: “*Operatori i shërbimit postar ka detyrimin që pritja, grumbullimi dhe ruajtja e dokumentacionit zgjedhor nga momenti i mbërritjes në Republikën e Shqipërisë deri në dërgimin e këtij dokumentacioni në KQZ duhet të bëhet në një ambient të posaçëm i cili duhet të ketë shërbim të monitorimit me kamera. Regjistrimet e këtij monitorimi ruhen në përputhje me parashikimet ligjore përkatëse, por në cdo rast deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve.*”

KRIIK rekomandon se **nevojitet të përcaktohet eksplicisht** se ambienti i posaçëm ku mbledhet dhe ruhet dokumentacioni zgjedhor **të monitorohet në mënyrë të pandërprerë me kamera, brenda dhe jashtë tij**, duke siguruar pamje të plotë mbi dhe përreth dokumentacionit zgjedhor.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",  
Nd.4, H.2, Ap.3,  
Nj.Adm.5,  
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396  
Tirana, 1001,  
Albania

**IX.** Në Kreun III.4, pika 3 e projekt-vendimit parashikohet se: “Operatori i shërbimit postar shënon në një regjistër të posaçëm të gjitha të dhënat mbi dërgesat e dokumentacionit zgjedhor, si të tilla, por jo vetëm, emër dhe mbiemër të dërguesit, shtetin, si dhe datën dhe orën e mbërritjes.”

KRIIK rekomandon se **nevojitet të përcaktohet në vijim se operatori njofton në mënyrë periodike** nëpërmjet postës elektronike mbi gjendjen e rregjistrimit dhe dërgesat që kanë mbërritur e që janë rregjistruar në të, **duke dërguar foto të faqeve të plotësuara në adresë të personelit përkatës në KQZ, çdo 1 orë.**

**X.** Në Kreun III.4, pika 5 e projekt-vendimit parashikohet se: “Operatori i shërbimit postar ka detyrimin e dorëzimit në KQZ të dokumentacionit zgjedhor brenda 24 orëve. Me këtë rast midis KQZ dhe operatorit të shërbimit postar mbahet një procesverbal. Dorëzimi mund të bëhet në ambientet e KQZ, ose në ato të operatorit të shërbimit postar.”

KRIIK rekomandon se **nevojitet të përcaktohet** dërgim periodik i dërgesave të mbërritura më të shpeshta, e maksimumi në afatin kohor të 12 orëve, nga mbërritja.

Po ashtu, nevojitet të **përcaktohet në këtë pikë, në mënyrë eksplicite se, në ditën e zgjedhjeve, dërgesat e fundit të mbërritura deri në ora 19.00** të dërgohen jo më vonë se 2 orë në KQZ.

**Duke ju falënderuar edhe njëherë për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin në vazhdimësi,**

**Me konsideratë,**

***Për* Koalicionin Për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)**

**Premto GOGO**

**Kryetar**

**Address:**

Rr. "Ymer Kurti",  
Nd.4, H.2, Ap.3,  
Nj.Adm.5,  
Tirana

**Mailingaddress:**

P.O.Box. 2396  
Tirana, 1001,  
Albania